

Pse po vonohet me procesin e decentralizimit ne Kosove?-18.12.2008

Moderatori: Mirëdita dhe mirëserdhët në Qendrën Mediale. Debatin e sotëm me temën “Pse po vonohet me procesin e decentralizimit në Kosovë?” e organizon Qendra Mediale me përkrahjen e Zyrës Finalndeze në Prishtinë. Procesi i decentralizimit si proces i cili është i rëndësishëm për të gjithë në Kosovë, është paralajmëruar shumë herë, por edhe shumë herë është shtyer. Për çka është kështu sot do të mundohen të na shpjegojnë panelistët tanë, nën-kryetarja e Këshillit nacional serb të Kosovës dhe Metohisë, dr. Rada Trajković, Ministri në Qeverinë e Kosovës Sadri Ferati dhe kryetari i Partisë së Pavarur Liberale Slobodan Petroviq.

Ju lutemi që fjala juaj hyrëse të mos zgjas më shumë se 8 minuta ashtu që t’i lëmë më shumë kohë kolegëve gazetarë për pyetjet e tyre. Do të fillojmë me përfaqësuesit e pushtetit, zoti Ferati urdhëroni.

Sadri Ferati: Shfrytëzoj rastin që qysh në fillim të përshëndes zotin Petroviq dhe zonjën Trajković. Në pyetjet tuaja do të përgjigjem edhe në gjuhën serbe ashtu që të jemi sa më të qartë. Do të jap një hyrje të shkurtër për të lënë më shumë kohë edhe për pyetjet tuaja. Është me interes të kemi një pushtet të fuqishëm lokal me kompetenca të gjera që parashohin edhe dokumentet relevante tashmë të aprovuara nga ana e Kuvendit të Kosovës me autonomi të gjerë të kryetarit dhe strukturave komunale si dhe me mbështetje të fuqishme financiare ashtu që të mund të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Në këtë drejtim është formuar edhe një grup ndër-ministor për decentralizim në krye të të cilit jam unë dhe zoti Piter Feith, shefi i ICO-së si dhe pesë nën-grupe të cilët udhëhiqen nga njerëz të përgjegjshëm, zëvendës-ministra, sekretarë të përhershëm, shefa të kabineteve dhe përfaqësues të ICO-së. Në këto grupe janë përfshirë përfaqësues të Ministrive që merren më tepër me pushtetin lokal, përfaqësues të opozitës, pozitës dhe përfaqësues të shoqërisë civile, krej kjo me dëshirë që ky të jetë një proces gjithpërfshirës, i dizajnuar mirë, me prospekte të mira, që të implementohet shumë shpejt. Grupi për legjislacion e ka kryer punën e vet. Grupi për implementimin e komunave të reja e ka hartuar konceptin dhe dizajnuar idenë, prej tani e deri kur të mbahen zgjedhjet e lira lokale, formimin dhe implementimi i strukturave të plota të këtyre komunave të reja, pra nga formimi i këtyre ekipeve fillestare e deri te administrata fillestare dhe përgatitja për bartjen e kompetencave nga komuna ekzistuese në komunën e re, pastaj grupi për bartjen e kompetencave. Procesi i bartjes së kompetencave shtesë do të zgjas nga janari deri në mars, veçanërisht në sferën e shërbimeve publike, komunale dhe shërbimeve komunale si dhe në skemën e mbrojtjes sociale, më vonë edhe bartja e pronësisë së kullosave, barishteve të ulëta dhe pyjeve. Kjo do të bëhet në grupe. Grupi për përcaktimin e kapaciteteve dhe donatorëve po bën një punë të shkëlqyeshme dhe ka një koncept të qartë të punojë me strukturat ekzistuese komunale ashtu që komunat e reja të mund t’i pranojnë sa më parë kompetencat dhe t’i kryejnë ato sa më mirë në interes të qytetarëve dhe po ashtu përgatitja e personelit në ato lokalitete ku parashihet instalimi i komunave të reja, i përgatitja atje ashtu që në momentin e instalimit të komunave të reja të mundemi sa më parë t’i transferojmë kompetencat me një profesionalizëm të lartë. Po ashtu kemi përcaktimin e

donatorëve të na ndihmojnë në fazën në të cilën gjendemi dhe kemi në disponim mjete të caktuara financiare ashtu që të mund të fillohet me zbatimin e projektit nëpër komuna, veçanërisht në ato komuna ku duhet të ngriten kapacitetet për administratën komunale, pra objektet dhe dokumentet përcjellëse. Çdo gjë është në pajtim me planin e Ahtisarit, i cili është i vetmi dokument i suksesshëm në këtë sferë për të cilën po flasim, të jap një kualitet që është shumë më i madh dhe më i lartë se të gjitha modelet në regjion. Me këtë, edhe njëherë po e theksoj, përveq qëllimit prioritar të formimit të komunave të fuqishme, në të njëjtën kohë ofron mundësinë që qytetarët e komunitetit shumicë dhe pakicë të kenë të gjitha të drejtat e parashikuara me Kushtetutë dhe ligjet e Kosovës, që komunat e tyre t'i implementojnë dhe të menaxhojnë këto të drejta në nivel lokal me çka do të jenë në gjendje të ndikojnë në kualitetin e jetës së vetë qytetarëve. Në të njëjtën kohë që ne, qytetarët e barabartë të Kosovës, të ndërtojmë perspektivën tonë euro-atlantike. Me këtë rast dëshiroj t'i falënderohem të gjithë aktorëve që ndihmuan Kosovën të tejkalojë ndarjen dhe një gjendje jo të favorshme, e cila është rezultat i një udhëheqjeje të keqe shumëvjeçare që është bërë në Kosovë, t'i falënderojë donatorët që kanë ndarë mjete të mëdha për këtë proces ashtu që komuna të jetë institucioni i parë që do të jetë aty për qytetarët dhe të gjitha nevojat e tyre. Në këtë mënyrë do të ndihmohet në ngritjen e standardeve udhëheqëse dhe me këtë do t'i ndihmojmë Kosovës në plotësimin e të gjitha kritereve në rrugën e gjatë drejt integritimit evropian. Kaq nga ana ime, dhe me dëshirë do t'i përgjigjesha të gjitha pyetjeve tuaja.

Sllobodan Petroviq: Dëshiroj t'ju falënderoj për ftesën, i përshëndes përfaqësuesit e mediave dhe kolegët e mi të nderuar panelistë që janë këtu sot. Ajo që është e lidhur me këtë temë është që kjo çështje është në interes të komunitetit serb. Pasi që supozoj që keni shumë pyetje lidhur me këtë temë do të mundohem të jem sa më i shkurtër ashtu që edhe ju të keni hapësirë për pyetje. SLS i përmbahet tri qëllimeve themelore që lidhen me programin e partisë sonë, të cilët janë shumë të rëndësishëm për këtë temë. I pari, i cili nuk ka alternativë, është mbijetesja e komunitetit serb në Kosovë. I dyti është zhvillimi ekonomik, përmirësimi i kushteve jetësore i njerëzve të rëndomtë, për të cilët politikanëve iu bie ndërmend vetëm para zgjedhjeve. Në vendin e tretë, jo sipas rëndësisë por sipas rendit, është kthimi i personave të dëbuar që janë larguar nga Kosova pas vitit 1999. Respektivisht, jo vetëm kthimi por edhe hartimi i projekteve për kthim të qëndrueshëm sepse thjesht ky është një proces i cili nuk varet vetëm nga SLS-ja. Nuk varet, të jem i sigurtë, as nga Qeveria e Kosovës. Një faktor i rëndësishëm këtu, përveq Prishtinës dhe Beogradit, është komuniteti ndërkombëtar. Ajo që është tema për të cilën jemi mbledhur sot është decentralizimi dhe pse po vonohet. Kjo është edhe pyetja ime, pse po vonohet decentralizimi? Qëndrimi ynë është që ky është, para së gjithash, interes i komunitetit serb dhe njeriut të rëndomtë dhe ne bëjmë përpjekje që ky proces të fillojë sa më parë. Ka disa arsye pse ne jemi për decentralizim dhe atë sa më parë që është e mundur. Aty duhet të jenë njerëz të këtushëm, që kanë kredibilitet dhe dituri për një proces të tillë. Njëra nga gjërat më të rëndësishme lidhur me komunitetin serb është pikërisht territori i cili do të duhet të jetë i përfshirë me komunën e re të Graçanicës, e cila me sipërfaqe është njëra nga komunat më të mëdha në Kosovë. Për momentin nuk e kemi një pasqyrë të qartë pasi që kjo zonë është nën kompetencën e Prishtinës, por qyteti i Prishtinës nuk ka instrument të ndal ndërtimin e egër në këtë vend. Shkak i gjithë kësaj është shitja e pronave serbe, gjë që është çështje personale e secilit individ, por ky është edhe një segment i cili frigon dhe motivon të shesin pronën serbe dhe të largohen nga Kosova. Do të thotë, ky është njëri nga

faktorët më të rëndësishëm. Ajo që është mjaft me rëndësi, si gjithkund në botë, është që decentralizimi është mjaft i rëndësishëm për njerëzit e rëndomtë që t'i përdorin ato institucione, d.m.th komunën. Është gjithmonë më mirë të ketë më shumë komuna, nëse për asgjë tjetër atëherë që populli të ketë mundësi që sa më parë të marr ato dokumente elementare që na duhen çdo ditë: certifikata, letërnjoftime etj. Është mjaft me rëndësi që të ruhet pasqyra demografike, sepse thjesht thënë, nëse decentralizimi vie më vonë, atëherë nuk ka kuptim të zbatohet decentralizimi. Sepse, sipas planit dhe programit decentralizimi nënkupton formimin e gjashtë komunave të reja, ku komuniteti serb është shumicë. Në këtë rast është kështu, sepse zvarritet ky proces, atëherë nuk do të jetë ashtu, sepse paraqitet ndrëtimi i egër, bëhen punime për të cilat nuk ka leje, kurse nuk ka institucione që do ta pengonin këtë. Pikërisht për këtë do të ishte shumë e dobishme dhe e rëndësishme që komuna e ardhshme e Graçanicës të formohet sa më parë, me kuadër të vyeshëm, njerëz të vyeshëm, të cilët do të dijnë të pengojnë këtë. SLS ka ndërmend të ndihmojë ata njerëz të cilët i kanë harruar të gjithë. Natyrisht, ne kemi mandat t'i ndihmojmë para së gjithash komunitetin serb përmes institucioneve. Ajo çka duhet të dini është që mbështetjen tonë po e kërkon një numër i madh i njerëzve. Ajo çka ka rëndësi të veçantë është që përkrahje kërkojnë edhe ata që nuk i përkasin komunitetit tonë, çka qartë tregon që ne kemi besimin që fitohet vështirë, që në këto kohëra është mjaft me rëndësi për neve. Ajo çka SLS-ja ka punuar në këtë temë të decentralizimit është që në periudhën e kaluar një ekip njerëzish që janë ekspertë në një lëmi, të cilët kanë hartuar projekte. Ajo çka është më e rëndësishmja për një komunë është plani urbanistik, dhe ne e kemi, të mos jem jomodest, të them idenë e planit urbanistik për 30 vitet e ardhshme, nga i cili do të kenë interes njerëzit që jetojnë në teritorin e kësaj komune. Këtë po e japim si kontribut. Ajo çka do të mbështesim është që procesi i decentralizimit i udhëheq njerëzit që jetojnë këtu dhe që kanë ndërmend të mbeten këtu. Problem akut midis komunitetit serb është që mungojnë njerëz të arsimuar, që janë të aftë, që kanë një kualifikim të caktuar për këto lëmi. Ajo çka është me rëndësi, dhe që është edhe e domosdoshme është të ketë njerëz të guximshëm, por edhe që dinë dhe duan të punojnë. Ajo që e dini edhe ju është që ne nga SLS-ja punojmë në mënyrë transparente, asgjë nuk punojmë fshehtëazi, asgjë nuk punojmë tinëz dhe e tërë ajo që është e mirë, që është në interes të komunitetit serb, që është në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës, të promovojmë, po ashtu flasim publikisht edhe për ata që punojnë kundër kësaj. Ju e dini që kemi pasur pak kohë të shoqërohemi dhe të promovojmë ato aktivitete në të cilat kemi punuar në periudhën e kaluar, do të thotë në 10-11 muajt sa jemi në institucione, por për këtë arsye kemi bërë disa buletine dhe akte që do t'i shihni. Për ata që nuk duan apo nuk dinë të lexojnë ekzistojnë fotografitë e asaj që SLS-ja ka punuar për 10 muaj. Këto janë disa gjëra që janë të dukshme. Kjo është diçka që është masë e vetme për mua, partinë time, Qeverinë, për të gjithë ata që duan të merren me politikë, për ata që, para së gjithash, duan të merren me njerëzit. Kjo është ajo që është bërë më së miri, këtu shihet gjithçka. Kjo është një porosi për të gjithë ata që kanë për qëllim të merren me mbrojtjen e interesave serbe në Kosovë. Unë i thërras të gjithë ata faktorë politik që e kanë atë qëllim që ta japin kontribut, po ashtu kam mirëkuptim për ata që nuk guxojnë ta thonë publikisht këtë, edhe ata njerëz janë të mirëseardhur. Ka njerëz që me deklarata të guximshme e kanë ndihmuar partinë tonë dhe kjo do të thotë shumë për ne. Njëra nga ato është edhe zonja Trajković, e cila e ka vizionin e saj, të cilin ajo e promovon...

Rada Trajković: Nuk e di nëse ndonjëherë të kam dhënë mbështetje.

Slobodan Petroviq: Nuk thashë që na keni dhënë mbështetje, por një erë pas shpine. Është fakt që nuk pajtohemi në një masë të madhe, por kjo nuk është arsye që të mos pajtohemi në pjesën që është interes i njeriut të rëndomtë. Gjithçka që është bërë deri tani ka qenë thjesht një politikanizëm, dhe shumë kanë përfituar nga vuajtjet e popullit serb në Kosovë dhe kjo duhet të thuhet publikisht. Nuk them që ne kemi bërë shumë, por nëse them që për 10 muaj kemi bërë më shumë se të gjithë për dhjetë vite, kjo është shkatërruese. Me këtë rast nuk dua të fajësoj askend. Ndoshta nuk ka qenë momenti. Ndoshta nuk ka pasur vend, ndoshta nuk ka pasur dije. Nuk dua të them që ka qenë me qëllim. Mirëpo, kjo është një arsye e mjaftueshme që të mbështetni të gjitha ato që i promovojmë ne.

Moderatori: T'i kthehemi prapëseprapë temës së debatit „Pse po vonohet me decentralizim“?

Slobodan Petroviq: Edhe njëherë ju falënderoj për vëmendje. Shfrytëzoj rastin që t'ju ftoj të bëni pyetje, në të cilat do të përgjigjem me dëshirë.

Rada Trajkoviq: Unë, para së gjithash, dua t'i falënderohem kësaj Qendre Mediale. Thjesht për arsye se është bërë një qendër ku po takohemi më së shpeshti dhe po bisedojmë në një atmosferë shumë demokratike dhe atë ata që duhet sa më shpesh të bisedojnë. Këta janë fqinjët, banorët e Kosovës dhe Metohisë, mendoj në serbët dhe shqiptarët, pamvarësisht a janë në institucione apo jo. Këtë vlerë që e keni kultivuar, mendoj se duhet ta vazhdoni, dhe meqenëse është fundi i vitit, dua t'ju uroj për atë që keni bërë. Normalisht që pres tribina të ngjashme dhe diskutime demokratike edhe në të ardhmen. Demokracia nënkupton edhe mospajtime. Demokracia nënkupton qëndrime të ndryshme, por demokracia nuk nënkupton përleshje, ose çkado që nënkupton dhunë. Unë shpresoj që të gjithë që e përcjellin këtë, veçanërisht përfaqësuesit e fuqisë së shtatë, në vitin e ardhshëm do të jenë aq të përgjegjshëm dhe do të punojnë në shkruarjen e teksteve në të cilat nuk do të favorizohen grupacionet ekstreme në krahasim me diçka që është porosia që duhet të thotë stabilizim të jetës. Tani të kaloj në temë. Unë do të filloja prej asaj që është realitet. E dëgjova me mjaft kujdes zotin Ferati dhe gjithë atë që po mundohet Ministria e tij në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar dhe po punon diçka që është fillim i projektit të decentralizimit të hapësirës së Kosovës dhe Metohisë. Tani ne kemi një problem të vogël, siç e dini UNMIK-u është ende pushtet dhe organ politik, por duhet të themi publikisht që UNMIK-u është organ politik pa mundësinë për të udhëhequr. Organ politik me mundësi virtuale dhe në këtë moment unë misionin e UNMIK-ut, duke pasur parasysh se është transformuar deri në atë masë dhe është bërë rikonfigurimit, do ta kisha quajtur më tepër si Ministri të Punëve të Jashtme të Kosovës në kuptim të asaj që nënkupton që përfaqëson hapësirën e Kosovës dhe Metohisë në institucionet ndërkombëtare ku Kosova nuk mund të përfaqësohet pikërisht për faktin që nuk e ka pavarësinë e rumbullakësuar apo të pranuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-

së. UNMIK-u, gjatë rikonfigurimit të fundit, ka lënë edhe disa administratorë, më së shumti në mjediset serbe. Kjo është më tepër si porosi dhe detyrë që çështja serbe në hapësirën e Kosovës dhe Metohisë nuk është zgjidhur. Multietniciteti i kësaj hapësire gjendet në kufirin e fundit të eksodit etnik, eksodit civilizues në kuptim të rrënimit të kishave dhe manastireve është realitet që është pas nesh dhe të cilin bashkësia ndërkombëtare nuk duhet dhe nuk guxon ta legalizojë. Në anën tjetër kemi një realitet tjetër i cili neve serbëve dhe shtetit serb në thelb nuk na pëlqen e kjo është që fuqia më e madhe politike në këtë moment, resurset më të mëdha, baza më e fuqishme financiare apo qendra, gjendet në zyrën e Piter Feithit. Tani ekziston një problem, të gjithë e dini sa gjatë jemi shtyrë me realizimin e EULEX-it në Kosovë dhe Metohi dhe atyre marrëveshjeve që rezultuan në Këshillin e Sigurimit përmes gjashtë pikave, si kërkesë për implementimin e EULEX-it në hapësirën e Kosovës dhe Metohisë, në atë kuptim unë i kam përjetuar ato gjashtë pika si çështje që duhet të zgjidhen dhe të cilat do të sjellin deri te stabilizimi dhe mbijetesa e përhershme e serbëve në këto hapësira. Të gjithë ju e dini që zoti Piter Feith ka një rol të dyfishtë. Në njërin anë, ai është Përfaqësues i lartë i Bashkimit Bashkimit Evropian, kurse në anën tjetër ka edhe pozitën e administratorit civil ndërkombëtar, i cili në të vërtetë paraqet një organ i cili nuk ka legalizim as në institucionet evropiane as në ato të OKB-së. Do të thosha që kjo pozitë, pozita e personit që i përfaqëson shtetet që e kanë njohur Kosovën, por duke pasur parasysh që decentralizimi paraqet një nevojë jetësore të komunitetit serb, i shërben atij që të mbrohet nga diskriminimi institucional që vie nga Ministra të caktuar dhe nga Qeveria e Kosovës. Decentralizimi është me të vërtetë një mënyrë për të organizuar jetën dhe për të mbrojtur të gjitha komunitetet dhe që definitivisht kjo hapësirë të provohet të bëhet thelbësisht një vend multietnik. Në këtë kuptim, shfrytëzoi këtë rast t'i apeloj shtetit tim, diskutimet e mëdha byrokratike në Këshillin e Sigurimit janë një realitet, siç është edhe padia para Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë, siç është ardhja e EULEX-it, kurse realiteti tjetër është ajo çka po ndodh në këtë vend. Këtë realitet tjetër duhet të gjithë ta kuptojnë dhe në këtë hapësirë nuk ka status kuo. Ne si shtet kemi huqur mjaft gjersa kemi luftuar në planin global, sepse në planin e ruajtjes së komunitetit serb mendoj se nuk kemi punuar mjaft mirë dhe për këtë arsye kemi faktin që nga dita në ditë komuniteti serb është më i dobët. Meqenëse kemi një status kuo të re në hapësirën e Kosovës dhe Metohisë, pres që këtë kohë ta shfrytëzojmë në mënyrë të duhur që nënkupton që do të hyjmë në procesin e decentralizimit dhe që këtë proces do ta bëjmë me zyrën e Piter Feithit si Përfaqësues i Lartë i BE-së. Zyra e Piter Feithit ka ndikim politik në lidhësinë institucionale dhe politike shqiptar, nga njëra anë që nuk është faktor i vogël në diçka që duam të arrijmë kurse nuk mund të anashkalojmë as faktorin shqiptar në këtë vend, dhe nga ana tjetër ne plotësisht e refuzojmë zotit Feith si bartës të funksionit tjetër, i cili vie nga një status jolegal dhe jolegjitim, si përfaqësues i vendeve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe Metohisë. Në këtë kuptim, unë pres që pas implementimit dhe fillimit të punës së EULEX-it, do të fillojmë punën edhe në problemet që nënkuptojnë decentralizimin, do të thotë formimin e komunave ku populli serb do të jetë dominant. Desha të them diçka, nuk dua të flas për partitë dhe nuk kam ardhur të komentojë të arriturat partiake, por kur thashë që UNMIK-u është mision relevant por pa fuqi, më duhet të them që problemi i partisë liberale është po ashtu që ajo është legale, por fuqia politike arrihet përmes zgjedhjeve dhe mbështetjes së popullit dhe kaq për këtë. Të mos hyjë në atë se sa kanë bërë institucionet shëndetësore në momentet më të vështira, ne duhet të kuptojmë që është e mirë çdo gjë që punohet mirë dhe dua të falënderoj për të gjitha ato që janë bërë mirë, por bota nuk ka filluar as nga unë e aq më pak nga Slllobodani dhe mendoj që njëherë do të ulemi dhe do të fillojmë të vlerësohemi në mënyrë të vërtetë. Kaq për fillim, por më duhet të them që e mbështes idenë e zotit Ishinger që hapësira e Kosovës dhe Metohisë dhe

pjesës tjetër të Serbisë të bëhe me të vërtetë vend i stabilitetit duhet që, para së gjithash, të gjithë ne së bashku të bëjmë përpjekje që t'i themi Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal nga Prishtina, në një kontekst me ndërmjetësim të bashkësisë ndërkombëtare, të bisedojë me Ministrinë e punëve të jashtme nga Beogradi dhe t'i paraqesin qëndrimet e tyre politike, të cilat janë plotësisht të kundërta, që së bashku të kuptojnë përgjegjësinë për ata që i përfaqësojnë e ky është populli që jeton dhe i cili ka nevojë për stabilitet pa marr parasysh a janë shqiptarë apo serb. Të gjithë janë të friguar dhe as njëri as tjetri nuk duan luftë, edhe njëri edhe tjetri kanë një jetë të vështirë përveq normalisht njerëzve shumë të pasur dhe në këtë kuptim unë pres që relaksimi i raporteve dhe fillimi i proceseve të vërteta në këto hapësira do të fillojë pikërisht ashtu që do të fillojë një komunikim shumë transparent i cili do të mundësojë që fqinjët serb dhe shqiptarë të fillojnë të bisedojnë normalisht.

Valdete Osmani TOP Channel: për zonjën Trajković. Në dhjetë muajt e fundit kanë ndodhur shumë procese në, siç e quani ju, Kosovë dhe Metohi dhe një numë i madh shtetesh e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës. A konsideroni që komuniteti serb së shpejti do të njohë realitetin e ri dhe do t'i bashkangjitet institucioneve kosovare?

Rada Trajković: Unë jam serbe dhe iu them që elita në Beograd nuk është e gatshme që të pranojë pavarësinë e Kosovës, siç këtë, mes tjerash nuk e ka bërë as Këshilli i Sigurimit dhe në këtë kuptim, duke respektuar të gjitha shtetet që e kanë njohur Kosovën, unë i përkas atyre njerëzve që mendojnë që statusi i pakryer krijon mundësi për biseda të reja dhe dialog, para së gjithash, midis institucioneve të Prishtinës dhe Beogradit. Pra krijohet mundësia që një trup i ri shqiptar dhe serb të bisedojë. Natyrisht do të kisha dashur që ai trup shqiptar të përbëhet jo midis organizatave ilegale por nga demokratë të vërtetë. Ndoshta më vonë kur t'i afrohem standardeve të Bashkimit Evropian dhe do të mund të lëvizim anëmbanë Bashkimit dhe anëmbanë Kosovës, ndoshta do të kuptohet që pavarësia e Kosovës nuk është zgjidhje apo ndoshta të kuptohet që pavarësia e Kosovës është një zgjidhje reale. Le t'i japim kohë standardeve të bëjnë relaksimin dhe marrje më të lehtë të vendimeve politike.

Valdete Osmani TOP Channel: Sa gjatë është kjo kohë?

Rada Trajković: Paj me të vërtetë nuk e di sa kohë do të na duhej. Populli shqiptar duhet të vendos të ndryshojë lidërsipin politik institucional dhe nuk e di sa do të duhet kohë që Serbia të ndryshojë lidërsipin e saj. Pra nuk pranohet Serbia si shtet, por në të njëjtën kohë kjo nuk do thotë që nuk duhet të bisedohet dhe të humbet kohë për shkak të status kuos.

Zijadin Gashi – Evropa e Lirë. Po flitet se do të organizohen zgjedhje vitin e ardhshëm. Çka sa i përket kësaj? Çka do të ndërmerret deri atëherë...a do të ketë komuna të reja? Për Rada

Trajkoviqin, a do të bashkëpunoni me Ministrinë për Administrim të Pushtetit Lokal sa i përket çështjes së decentralizimit? U tha që do të ketë bartje të kompetencave dhe cili do të jetë roli juaj në këtë?

Sadri Ferati: Ju falemnderit, dëshiroj që të jem sa më i shkurtër dhe të përfaqësoj punën e madhe në nivelin e Ministrisë. Unë nuk arrita të them se a po vonohet me decentralizimin dhe ju falënderoj që ma përkujtuat këtë. Decentralizimi si proces dhe nga aspekti i vullnetit politik të institucioneve kosovare nuk ka kurrfarë vonesash. Nuk kemi vonesa as në hartimin e dokumenteve. Nuk jemi të kënaqur me dinamikën as me fuqizimin kur është në pyetje decentralizimi tek komuniteti serb. Kur bëhet fjalë për komunat ku banorë shumicë janë serbët, ne bëjmë gjithçka që është e mundur që komuniteti ta udhëheq atë proces, por kjo nuk po ndodh. Ne nuk dëgjuam se ekziston përgjegjje nga ana e komunitetit serb dhe më vjen mirë që këtu dëgjojmë ftesa për biseda, sepse pa ata njerëz ai proces nuk mund të fillojë, do të thotë komunitetet duhet të udhëheqim me realizimin e të drejtave të tyre. Kur jemi tek ajo se kujt i përshtatet ky proces dhe kur jemi te integrimi në shoqërinë kosovare, kush po e pengon kush po e stimulon? Ne kemi përgjegjje për këtë. Kjo nuk është tek institucionet kosovare. Pra problemi qëndron tek komunitetet të cilat nuk duan të marrin përgjegjësinë dhe procesin. Pra kemi pesë komuna të reja dhe thjesht nuk dua të komentoj se pse këto komuna nuk po funksionojnë. Pyetja është se a dëshiron dikush edhe dhjetë Mitrovica të reja? Poenta është që qytetarët e të gjitha nacionaliteteve kanë të drejta të barabarta. Me pakon e Ahitsarit është realizuar një pjesë e kësaj. Nuk është i mundur zbatimi i pjesshëm i pakos së Ahitsarit. Pra do të bëhet zbatimi i të gjitha pjesëve e jo vetëm të atyre që janë në interes të vetëm njëres palë. Ka ekzistuar ideja që banorët shumicë të kenë të drejta udhëheqëse, mirëpo asgjë pa mekanizma të mbrojtjes së komunitetit pakicë brenda komunave. Këtu nuk ka diskutim. Do të punohet në atë që edhe komunat ekzistuese të integrohen në institucionet kosovare pavarësisht a bëhet fjalë për qytetarët e Ranillukut, Novobërdës apo Mitrovicës. Të gjithë duhet të kenë të drejtë të kthehen në pronën e tyre dhe të udhëheqin me institucionet e tyre. Do të shfrytëzoj rastin ta dëgjoj Rada Trajkoviqin dhe të ftoj, si Ministër, të gjithë qytetarët e interesuar dhe Ministrat e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë që të bisedojmë për këtë dhe për kualitetin e jetës së qytetarëve dhe kjo është esenca. Unë vetëm mund të them që me Kosovën do të udhëheqin Kosovarët dhe në këtë temë dua të bisedoj me të gjithë faktorët e të gjitha institucioneve, nga vendet fqinje e të ngjashme. Pra jam i gatshëm të bashkëpunojë me të gjithë për mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

Rada Trajkoviq: Duke respektuar atë për çka foli zoti Ferati, gjë që dua të besoj se është përcaktim dhe dëshirë e tij e sinqertë, por më duhet të them që ne në teren ballafaqohemi me fakte të tjera, të cilat i demantojnë ato që u thanë këtu. Ajo që tha Ministri Ferati nuk ka kuptim në teren sepse ajo që është bërë është që komuniteti serb gjithnjë e më tepër po kompromitohet apo po zvogëlohet numri i serbëve në Kosovë. Kështu kemi pasur iniciativa edhe nga pushteti qëndror në Prishtinë edhe nga pushteti lokal ku është munduar që në komunitetet serbe të fillohen projekte që janë në kundërshtim me interesat e tyre. Këtu do të veçoja projektin e ndërtimit të xhamisë në Berivojcë, i cili është mjedis serb, kështu që në këtë mënyrë është bërë presion dhe shpërngulje të serbëve. Në regjionin qëndror kemi pasur rastin ku Qeveria e

Kosovës, ku punon edhe zoti Ferati, dhe ku ka disa Ministra nga partia Liberale, filluan iniciativën për ndërtimin e lagjes në Staro Gracko, për të ashtuquajturit veteranët e UÇK-së. Pikërisht në vendin dhe tek ata që, siç e dini, kanë qenë viktimat e para dhe ku 14 korrëtarë janë vvarë në të njëjtën kohë. Pas kësaj kemi pasur propozimin për ndërtimin e lagjes midis Preoce dhe Lepine, asaj pjese e cila duhet t'i takojë komunës së ardhshme të Graçanicës. Në Prilluzhë po ndërtohet shkolla që do të ndikojë në destabilizimin dhe pakësimin e numrit të serbëve. Është e tepërt të flitet për Gjakovën, ku në vendin ku dikur ka qenë e ndërtuar një kishë, tani po ndërtohet një park. Krej kjo në të vërtetë flet për qëllimet e këqija të liderëve të caktuar brenda insitucioneve lokale dhe qëndrore. Në këtë kuptim, më duhet të them që përcaktimi im është i tillë. Për t'u ruajtur ndikimi i Serbisë në Kosovë duhet të ruhet komuniteti serb në Kosovë dhe këtu decentralizimi mundet mjaft të ndihmojë. Beogradi duhet të bisedojë me Prishtinën, sepse ju e dini që njeriu duhet të bëjë gjithçka që është e mundur që të mbijetojë dhe të jetë pragmatik. Duhet të kemi qëllime afatgjate dhe strategji. Do të doja që ky vend të jetë i sigurt për të gjithë. Dua të them që pavarësisht që EULEX-i është shtrirë pa probleme, do të kemi probleme kur të vijë deri te legalizimi i kriminalitetit dhe njeërzve të cilët janë përndryshe shumë të infiltuar ao bartës të lidërshiptit dhe na pret një periudhë që duhet të bëjmë gjithçka që të ruajmë komunitetin serb. Duhet të punohet në decentralizim.

Sllobodan Petroviq: Meqenëse, thënë më së buti, nuk është korekte ajo çka tha Rada Trajkoviq, për shkak të opinionit, dua të them që Qeveria e Kosovës nuk e ka marrë vendimin për ndërtimin e lagjes së veteranëve, e aq më pak me pjesëmarrje të Liberalëve. Këtë e tregon edhe fakti që zonja Trajkoviq edhe nuk e di se ku ndodhet ai vend. Ai ndodhet midis Preoce dhe Lepine, te Suvi Doli. Partia Liberale, e ne kemi edhe dëshmitarë këtu, ka qenë ajo që edhe e ka stopuar ndërtimin e kësaj lagjeje. Për shkak të opinionit, kjo nuk është korekte. Ajo duhet ta dijë që me ndihmën tonë e edhe me mbështetjen e Ministrisë për Shëndetësi, është liruuar një kontigjent i madh barnash. Mendoj se është jokorekte që në mënyrë kuturu vetëm të supozohen disa gjëra.

Rada Trajkoviq: Me respekt unë do të thosha vetëm diçka. Nuk e kontestoj luftën e SLS-së për projekte për të cilat bëhet fjalë këtu. Më duhet të them që zoti Zanieri e ka dhënë autorizimin për importin e barnave që vijnë në doganën në jugun e Mitrovicës, i cili është bërë bedem i vërtetë për transportin e barnave dhe i falënderoj nëse edhe ata kanë ndihmuar në këtë drejtim. Të gjithë bisedojmë, kam biseduar edhe me Këshillin politik të NATO-s dhe me të tjerët që të stopohen projekte të ndryshme kundër serbëve, kështu që mendoj se do të kishte qenë mirë që të kishte pasur më shumë intervenime. Kjo flet se sa ka komunikim midis nesh, por është me të vërtetë mirë nëse të gjithë janë për interesa të njëjtë. Unë nuk e kam me vete, por do t'ua sjell dokumentin origjinal ku thuhet se „Qeveria e Kosovës e aprovon ndërtimin e lagjes për veteranët e luftës...“

Sllobodan Vujiq, kryetar i shoqatës së malazezve: ku janë malazezët në procesin e decentralizimit. Zoti Ferati, ju thatë që do të bisedonit edhe me Malin e Zi por çka keni bërë për

popullin malazez në Kosovë? A mos mendoni që të bisedoni me Kryeministrin e Malit të Zi për serbët? Po ashtu zoti Petroviq, kur bisedon me Serbinë, EULEX-in e të tjerët, nuk na përmend askund. Zonja Trajkoviq thotë që decentralizimi është për mbijetesën e serbëve, kurse decentralizimi është e mirë për të gjithë që jetojnë në Kosovë. Po bëhet asimilim ndaj malazezëve.

Rada Trajkoviq: Unë jam atëherë malazeze e asimiluar.

Slobodan Vujiq: Ja shikoni. Pra si mendoni që të kthehemi kur nuk marim pjesë askund, dëgjoj po i përmendni edhe çifutët e ku janë malazezët?

Sadri Ferati: Po, kështu kam thënë, mirë më keni dëgjuar. Si Ministër do të kisha biseduar me të gjithë, me ministrat e të gjitha vendeve për qytetarët e të gjitha nacionaliteteve. Gjithçka për të drejta të barabarta të të gjithë qytetarëve. Prapë do ta them, të gjitha bashkësitë etnike dhe grupet e interesit duhet të udhëheqin me të drejtat e tyre, por ne nuk i kemi ato adresa. Unë me të vërtetë e shoh Kosovën si shtet të të gjithë qytetarëve. Unë nuk po e shoh atë adresë. Është e vërtetë që ekzistojnë serbët dhe malazezët dhe nuk e di se çka ka ndodhur që themi vetëm serbët. Le të organizohen dhe le të marrin adresë dhe ne jemi të gatshëm të bisedojmë thjesht me të gjithë. Vetëm të them që nëse ka diçka që nuk di do të pranoj që nuk e di, por me sa di unë ne nuk kemi një adresë të tillë. Unë do ftoja tani që nëse ka liderë apo strategji le t'i drejtohen lirisht zyrës sime.

Rada Trajkoviq: Gjithmonë them e edhe tani do të them. Të mitë janë Vujaqiq e ju jeni Vujiq...nuk dua kur identifikohem, e dini. Gjithmonë them dhe po e përsëris, lidërshipi politik e ka shpallur pavarësinë e njëanshme dhe njënacionale. Këtë pavarësi po e ruan NATO-ja dhe buxhetin po e mbush bashkësia ndërkombëtare. Që kur di për vete këtë hapësirë e financon Qeveria e Serbisë. Multietnicitetin në Kosovë e mban Qeveria e Serbisë. Nga respekti ndaj atyre që e kanë mbështetur babain tim, gjyshin tim, jo pse ka ardhur nga Mali i Zi, edhe zotin Ferati para do kohësh, sepse të gjithë ne i kemi letërnjoftimet që jemi të lindur këtu kurse jemi banorë të Serbisë, konsideroj që përgjegjësia bie mbi Beogradin. Kemi qenë dhe kemi mbetur pjesë e atij shteti derisa të ndryshohet Rezoluta.

Sadri Ferati: Vetëm të plotësoj, me dëshirë do të pranoj ftesën e Malit të Zi për këtë temë. Shihet se kemi dallime, gjyshin tim Serbia nuk e ka financuar por ia ka marrë çdo pikë djerse, e përsëri gjendemi tani në një rrjedhë ku të gjithë duhet të jetojmë nga djersa jonë. Askush nuk duhet as të shtojë e as të heq asaj që e meritojmë. Ky është fillimi i perspektivës dhe bisedës. Ju falemnderit.

Slobodan Petroviq: Para së gjithash, unë e njoh shumë mirë Slobodanin që 30 vite, kemi qenë shokë të shkollës dhe unë këtë e kuptoj si konstatim. Decentralizimi është pikërisht për ato komuna ku serbët janë shumicë, dhe jam i sigurt që e dini se misioni ynë i partisë promovon multietnicitetin në nivel e veçanërisht për njerëzit që kanë jetuar këtu para vitit 1999. Te ne kurrë nuk do të ketë probleme, por problemet më të mëdha duhet dërguar Begoradit, Prishtinës, Brukselit dhe Uashingtonit. Të shfrytëzoj rastin të them që gjatë kohës sa jemi në institucione kemi takuar njerëz të mirë dhe të këqij, kurse unë jam i lumtur që kemi takuar më shumë njerëz të mirë. Ju dëshiroj çdo të mirë për festat në vijim.

Sadri Ferati: Unë do të doja të nxjerr njëfarë përfundimi dhe të përcaktoj se ku jemi për të vërtetuar që institucionet kosovare dhe obligimet që dalin nga plani gjithpërfshirës ende qëndrojnë dhe ajo që na mungon si komponentë është bashkëpunimi i qytetarëve të komunitetit serb. Më vjen mirë për mbështetjen që iu dha këtij procesi nga kjo tryezë e rrumbullakët, për integrimin e të gjitha komuniteteve etnike e edhe komunitetit serb. Edhe njëherë i ftoj të gjithë, të them që ekziston përgjegje e qytetarëve të komunitetit serb ku ua interpretojmë këtë proces dhe e afirmojmë këtë proces. U japim ofertë të gjitha komuniteteve të udhëheqin me të drejtat e tyre dhe që me bashkëpunim çdo gjë do të ishte më e shpjetë dhe më e lehtë. Nuk do të kishte shqetësime. Qytetarët duhet të udhëheqin me komunat e tyre në të gjitha mjediset. Pra ajo që ka kaluar është pas nesh dhe tani është koha që secili qytetarë të shfrytëzojë të drejtat e veta dhe që secili të jetë qytetarë i rendit të njëjtë. Nuk do të jetë lehtë, ka presione dhe dilema, por vetëm me pajtimin e të gjithëve do të shihni se sa të suksesshme janë institucionet kosovare. Falemnderit edhe njëherë.

Moderatori: Me këtë përfundoi debati për decentralizim.